



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Gjakovë-Djakovica-Gjakova

Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. /2022

Datë:07.02.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe nën 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.02.2022 pas diskutimit lidhur me pikën e 9 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit vlerësues për vazhdimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për vazhdimin e procedurave për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së paluajtshme Komunale sipas vendimit paraparak për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së paluajtshme Komunale me numër 01nr.020-37472 të datës 21.07.2016, në parcelën kadastrale 16371/1 Z.K Gjakovë Qytet, me sipërfaqe prej 0.03.56ha, me këtë përbërje :
 1. Z. Arben Bakalli, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
 2. Z. Ferdinand Kolaj, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
 3. Znj. Albulena Zuka-Vokshi, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës .
 4. Znj. Lirianda Dahsyla, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës .
 5. Z. Idriz Daci, përfaqësuese e sektorit jo qeveritar .
2. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi ti vazhdoj procedurat e filluara sipas njoftimit të datës 05.05.2021 me 01 nr.463/02-11068, në harmoni me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së paluajtshme Komunale .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Anëtareve të Komisioni .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit .

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Znj. Arbënësja Kuqi

